

## Mbi

### Auditimin e Brendshëm

#### Ushtruar në Qëndren e Zhvillimit - Bashkia Shkodër

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi i plotë në– Qendra e Zhvillimit - Bashkia Shkodër, për periudhën 01 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2017 nga auditimi rezultoi:

#### Permbledhje ekzekutive

##### **Zbatimi i rekomandimeve të lëna në Auditimin e mëparshëm:**

Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nuk kanë gjetur zbatim .

**Funksionimi i kontrollit brendshëm:** Nuk ka rregullore të brendshme të miratuar, nuk janë përcaktuar objektivat e institucionit, nuk është hartuar deklarata e qëllimit, nuk ka plan strategjik dhe vjetor , nuk është hartuar regjistri i riskut.

**Vlersimi i drejtimit:** Ka mangësi të theksuara organizative, kryesisht në caktimin e detyrave funksionale, në hartimin e planeve strategjike dhe vjetore, në hartimin e programeve të rehabilitimit të personave që frekuentojnë qendrën Zhvillimit, ka mangësi në vendimarrjen për realizimin e shpenzimeve , në mbajtjen e dokumentacionit ligjor, në rakordimin e veprimeve financiare.

**Përformanca:** Qendra e Zhvillimit, ka mangësi në menaxhimin e shpenzimeve, në realizimin e objektivave të institucionit .

**Sistemi buxhetimit:** Ka mangësi në buxhetimin e fondeve të dispozicion, nuk ka një sistem të qartë të buxhetimit, zërat e buxhetit nuk argumentohen sipas treguesve ekonomik, ka mangësi në ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit.

**Menaxhimi i shpenzimeve:** Ka mangësi të theksuara në menaxhimin e shpenzimeve. Veprimet e nëpunësit Autorizues dhe nëpunësit zbatues, përbëjnë një rrisht të lartë në kryerjen e shpenzimeve me kursim dhe efektivitet, si dhe çënojnë arritjen e përmbushjes së objektivave të institucionit.

## **GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**1.Gjetje** Në referencë të germës “d” neni 12 i ligjit nr. 114/2015“Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” Titullari i Qendrës Zvillimit, brenda 30 ditëve nga data e raportit përfundimtar të auditimit, duhej të kishte hartuar, miratuar dhe ndjekë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, Ish- Drejtuesit dhe drejtuesi aktual nuk kanë bërë përpjekje për zbatimin e rekomandimeve të lëna me përjashtim të përpjekjeve për hartimin e Rregullores së institucionit.

**2.Gjetje** Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Anekseve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr.108 datë 17.11.2016, Qendra e Zhvillimit - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjinë dhe listë kontrollet për vizitat në tërren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve të punës, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

**Rekomandimi nr.1** Përshtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

**Rekomandimi nr. 02:** Përpilimin e planit vjetor të punës, hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e planit veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përpilimin e listës kontrolleve për vizitat në tërren.

**3.Gjetje** Referuar germa “b” pika 4 neni 9 i ligjit 10296 date 8.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, referuar pikës 01, Udhëzimit nr. 1730 datë 27.09.2010 “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësitë të kufizuara, drejtimi duhej të kishte përcaktuar, misionin, objektivat, shërbimet që ofrohen, procedurat e shërbimeve etj. Nga auditimi i kryer rezultoj se drejtimi nuk ka përmbytur detyrën funksionale, përfshirë misionin, objektivat, Shërbimet që ofrohen, procedurat e shërbimeve etj. Nëpunësi autorizues nuk ka bërë përcaktimin e objektivave të institucionit e ndarjen e përgjegjësive, të dokumentuar që lidhen me vendimmarrjen kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit me strukturat e veta vartëse. Mungojnë dhe nuk janë caktuar dhe dokumentuar procedurat e brendshme që në të gjitha rastet do të duhet të garantojnë se punonjësit mbikqyren në menyrën e duhur në kryerjen e detyrave, sipas varësisë hierarkike, sipas

niveleve specialist përgjegjës drejtues. Nuk është hartuar deklarata e qëllimit Nëpunësi autorizues nuk ka kërkuar përpilimin e planeve vjetore dhe mujore

**4.Gjetje** Referuar nenit 12 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, pikës 1.2 të udhëzimit nr. 21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve , nëpunësi zbatues duhej të kishte përgatitur dokumentacionin perfundimtar të buxhetit , duhej të kishte kryer raportime periodike për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave për pjesën e të ardhurave e shpenzimeve, duhej të kishte mbajtur sistemin e kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave, duhej të kishte bërë identifikimin dhe krijimin e regjistrit te riskut, duhej të kishte bërë dokumentimin në kohë të gjithë transaksioneve financiare , duhej të kishte ushtruar kontrollin e brendshëm në magazinë. Nga auditimi i kryer rezultoi se Nëpunësi Zbatues nuk ka përgatitur dokumentacionin perfundimtar të buxhetit , nuk ka bërë raportime periodike për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave për pjesën e të ardhurave e shpenzimeve, nuk ka mbajtur sistemin e kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave, nuk ka bërë identifikimin dhe krijimin e regjistrit te riskut nuk ka bërë dokumentimin në kohë të gjithë transaksioneve financiare nuk ka ushtruar kontrollin e brendshëm në magazinë.

**Rekomandimi nr. 03: Përsa i përket drejtimit, rekomandimin do e drejtojmë tek Titullari i Bashkisë.**

**5.Gjetje** Në reference të pikës 1 kreu II të V.K.M nr. 425 datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike të përkujdesjes shoqërore”, personat që pranohen në Qendrën e zhvillimit , duhej të jenë persona me aftësi të kufizuar, mendorë, fizikë, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të caktimit aftësisë për punë, moshë 0-25 vjec, dhe si dokumentacion shoqëruës , certifikata e lindjes, certifikata e gjendjes civile, dy fotografi, vërtetim i gjendjes ekonomike të familjes , lëshuar nga seksioni i ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore, kopje e vendimit këshillit Bashkiak apo komunal,kërkesa për sistemim, deklarata noteriale per dhënie pelqimi të prindit për pranim në institucion. Nga auditimi i kryer ka rezultuar:

- Nga 75 persona të regjistruar me dosje personale , 29 persona janë nën moshën 25 vjec, 35 persona janë të moshës nga 29-54 vjec dhe 7 personave nuk ju dihet moshë.
- Nga hyrja në fuqi e vendimit të mësipërm, e deri tani në Qendrën e Zhvillimit janë pranuar 14 persona, dhe për të gjitha rastet e pranimit nuk është marrë vendim i këshillit Bashkiak apo komunal për pranim.

- Nga 75 persona të regjistruar me dosje personale, nuk janë të pajisur me kartë identiteti 48 persona .
- Nga 75 persona të regjistruar me dosje personale, asnjë person nuk është i pajisur me karte shëndeti.
- Nga 75 persona të regjistruar me dosje personale, 6 persona nuk e kanë të përcaktuar kujdestarinë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 1 kreu II të V.K.M nr. 425 datë 27.06.2012 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit nevojshëm për pranimin e personave me në institucionet rezidenciale publike dhe jo publike të përkujdesjes shoqërore”

**6.Gjetje** Në referencë të pikës 6 të udhëzimit nr. 1730 datë 27.09.2010 “Për zbatimin e standarteve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale dhe ditore”, Qendra e Zhvillimit duhej të kishte perpiluar raportin e ecurisë, përfshirë raportin për vlersim të nevojave dhe planin e kujdesit ,duke bërë rishikimin dy herë në vit. Nga auditimi i kryer rezultoi se Qendra e zhvillimit, nuk ka bërë vlersim të nevojave dhe planin e kujdesit.

**Rekomandimi nr. 04:** Qendra e Zhvillimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashkinë Shkodër dhe Shërbimin Social Shtetëror të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të personave që frekuentojnë qendren e zhvillimit , të beje plotësimin e dokumentacionit, si dhe per personat mbi 25 vjec të beje sistemimin në qendra të tjera të ngritura për këtë qëllim.

**Rekomandim nr. 05:** Në Qendrën e zhvillimit të pranohen vetëm përsinat, për të cilet është marrë vendim nga këshilli Bashkiak.

**Rekomandim nr.06:** Për të gjithë personat që frekuentojnë qendren e zhvillimit të bëhet vlersimi i nevojave dhe plani i kujdesit si dhe te hartohet raporti i ecurisë, duke bërë rishikim dy herë në vit.

**7.Gjetje** Referuar neneve 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” Qendrës Zhvillimit duhej të kishte ngritur sistemin e monitorimit, por nga auditimi rezultoi se kjo drejtori nuk ka ngritur sistem monitorimi.

**Rekomandim nr.07** Ngritjen dhe funksionimin e sistemit te informimit dhe monitorimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efencës te institucionit Qendres Zhvillimit .

**8.Gjetje** Në referencë të neneve 24, 64 te ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 17,21, 37 të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, neni 5 i ligjit nr. 10405 datë 23.04.2011 “Për kompetencat në caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, Qendra e zhvillimit- Bashkia Shkodër duhet të kishtë derguar kërkesë me shkrim për financim personeli, duke bërë argumentim me shkrim, bazuar në numrin e punonjësve dhe manualin e zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për personat me aftësi të kufizuar”, me pas stafi I Bashkisë Shkodër, bazuar në mundësitë financiare duhej të

kishte bërë vlersimin dhe me pas të hartonte projekt -vendimin për këshillin Bashkiak, për financim dhe shtesë personeli në Qendrën e Zhvillimit. Nga auditimi I kryer ka rezultuar se vendimi I marrë për shtesë personeli nuk ka ndjekur procedurën ligjore nga kërkesa për shtesë personeli, miratimi nga Drejtoria e Shërbimit Socile Strehimit, propozimi për shtesë punonjesish nga Drejtoria e Burimeve Njerzore, dhe hartimi I projekt vendimit.

**Rekomandim nr.08:** Ky rekomandim do t'i propozohet Titullarit të Bashkisë.

**9.Gjetje** Në reference të pikave, 1,2 të V.K.M nr.117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtje, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Në dosjen teknike të nëpunësit duhet të përfshihen: 1. Fletëinventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje. 2. Fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit, formati i së cilës mund të jetë i ndryshueshëm. 3. Të dhënat që do të përmbajë dosja duhet të shoqërohen me dokumentin përkatës që vërteton pohimin e bërë: a) Certifikata e gjendjes familjare; b) Diploma e shkollës së lartë, lista e notave; c) Certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; d) Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja; e) Dokumenti i laurimit me gradë shkencore; f) Të tjera. 4. Dokumentet duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe janë pjesë përbërëse e dosjes. 5. Të gjitha dokumentet në dosje shkruhen në inventarin e saj. Fletë inventari do të firmoset nga nëpunësi dhe drejtori i personelit. Nga auditimi I kryer rezultoi se në raste janë pranuar në dosjet personale të punonjësve dokumente të fotokopjuara të pa vërtetuara nga noteri.

**Rekomandim nr.09:** Të behet trajnim I punonjësit ngarkuar për mbajtjen e dosjeve të personelit si dhe të bëhet plotësimi dosjeve të personelit sipas lidhjes 2 pika 2 e V.K.M nr.117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtje, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

**10.Gjetje** Referuar pikes faqe 48 të manualit zbatimit standarteve shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar, personeli I punësuar duhet te ketë kryesisht kualifikimin e mësuesisë dhe punonjësit social, nga auditimi I kryer rezulton se punonjësit e punësuar nuk kanë kualifikimin e kërkuar sipas tabelës në faqen 49 te manualit mësipërm.

**Rekomandim nr.10:** Ky rekomandim do t'i propozohet Titullarit të Bashkisë.

**11.Gjetje** Bazuar në planin e buxhetit miratura nga institucioni qendror financues, Qendra e Zhvillimit , bazuar ne gërmën “d”, pika 96 e udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte zbatimit Buxhetit”, duhej të kishte bërë detajimin e zërave të buxhetit dhe të kërkonte pranë Kryetares Bashkisë Shkodër për miratimin e tij. Nëpunësi Autorizues dhe zbatues nuk kanë paraqitur pranë Bashkisë Shkodër planin e buxhetit të detajuar sipas zërave dhe nënzërave të buxhetit për të marrë miratimin nga Bashkia Shkodër.

**Rekomandim nr 11 :** Nëpunësi Autorizues dhe zbatues, pas miratimit të buxhetit , të bazuar në objektivat dhe nevojat e institucionit të bëjnë detajimin e zërit 602 në nënzëra dhe ta paraqesin për miratim pranë Kryetares së Bashkisë.

**12.Gjetje :** Në referencë pike 263 të udhëzimit ministrisë financave nr. 02 date 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, duhej të ishte përpiluar gjurma e auditit, nga auditimi i kryer rezultoj se për të gjithë periudhën nuk është përpiluar gjurma e auditit. U bë auditim lidhur me përpilimin e gjurmeve të auditit për alokimin dhe rialokimin e fondeve, për kryerjen e shpenzimeve publike.

**Rekomandim nr 12 :** Të kërkohet me shkrim, pranë Drejtorisë Planifikimit buxhetit në Bashki për të marrë asistencën e nevojshme për përpilimin e zbatimit të gjurmës auditit për buxhetin.

**13 Gjetja nr.** Në reference të pikave 140-157 të udhëzimit nr. 02 date 06.02.2012

“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” u bë auditim lidhur me marrjen e angazhimit dhe kryerjen e shpenzimeve publike nga ku rezultoi:

- Sipas pikës 140-141, kërkesa për shpenzim duhet të paraqitet nga drejtuesi funksional I kryerjes së shpenzimit duke respektuar fondet e planifikuara, duke ju drejtuar nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues . Kjo kërkesë nuk ka gjetur zbatim.
- Sipas pikës 142 , nëpunësi zbatues bazuar në planin e buxhetit duhej të kishte dhënë opinionin lidhur me kryerjen e shpenzimit, kjo kërkesë nuk ka gjetur zbatim
- Sipas pikës 143 nëpunësi autorizues mbi bazën e kërkesës nënshkruan ,urdhër prokurimin apo sipas rastit kontratën. Kjo kërkesë nuk ka gjetur zbatim .
- Në referencë të pikës 152-154,nëpunësi zbatues,kontrollon mjaftueshmerinë e disponibiliteteve sipas parashikimeve në planin e arkës, kontrollon dokumentet origjinale , që vertetojnë kryerjen e pagesës, më pas I kërkon operatorit ekonomik formularin e bankës dhe nëse I gjithë dokumentacioni është në rregull përpilon urdhër shpenzimit. Nëpunësi zbatues ka përpiluar urdhër- shpenzim bazuar në dokumente jo ligjore. Kjo gjetje është konstatuar dhe në auditimin e mëparshëm si dhe është lënë rekomandim për përmirësim, por nuk është zbatuar.

**14 Gjetja** Në reference të germave a,b,c pika 8 dhe lidhja II e V.K.M nr .717 datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetes në institucionet buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” i ndryshuar, Qendra e Zhvillimit duhej të kishte paraqitur kërkesën pranë Drejtorisë Shëndetit Publik, për të bërë përcaktimin për vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e të dëmshmërisë, për çdo vend pune. Pas përcaktimit të shkallës së vështirësisë e dëmshmërisë, titullarët e institucioneve buxhetore paraqesin kërkesën për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.Pas marrjes së miratimit nga dy ministritë e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, titullarët e institucioneve miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Për institucionet qendrore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe ato, rajonale e vendore, ky miratim bëhet nga ministri përkatës, në varësi të të cilit janë këto institucione. Nga auditimi i kryer rezultoi se punonjësve me detyre “kujdestar” u është llogaritur vështërsi për punë të

vështira sipas grupit tretë për 20 % të pagës së klasës VI, ndërsa sanitarëve u është llogaritur vështërsi për punë të vështira sipas grupit katërt për 25 % të pagës së klasës ‘VI’. Llogaritja e pagesës së vështërsisë është bërë në kundërshtim me pikat a,b,c , pika e 8 e V.K.M nr .717 datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, i ndryshuar. Nga ana jonë nuk u bënë llogaritjet e efektit financiar, pasi dhe në auditimin e mëparshëm ka qënë e njejta situatë,ku është njoftuar dhe Ministria Përgjegjëse dhe nuk ka patur reagime në përmiresimin e situatës.

**15.Gjetja** Në referencë të pikës 5 të V.K.M nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës e pushimit në institucionet shtetërore” i ndryshuar, punonjësit që punojnë jashtë kohës normale të punës duhet të kompensohen me pushim, brenda dy muajve pune nga koha e kryerjes së orëve shtesë, si dhe për punën e kryer në turnin e dytë, të tretë dhe në festa zyrtare të bëhej shtesa e pagës, përkatësisht 25 dhe 50%. Nga auditimi i kryer rezultoj se për orët e kryera jashtë kohës normale punës nuk është bërë kompensimi me pushim por është bërë pagesa për punën e kryer.

**16.Gjetja** Në referencë të pikës 2 te V.k.M nr. 594 date 22.12.1997 “Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësin e tij” nëpunësi zbatues duhej të kishte plotësuar regjistrin e punëmarrësve, nga auditimi i kryer rezultoj se nga ana e nëpunësit zbatues nuk është plotësuar regjistri i punëmarrësve.

**Rekomandim nr 13:** Të bëhet rillogaritja e pagave për pagesat e kryera për turnet e dyta, treta dhe festa zyrtare per vitet 2016,2017,2018, për diferencat e përfituara më tepër të fillojë ndalesa deri në likuidimin e plotë të detyrimit të përfituar më tepër.

**Rekomandim nr 14:** Për punën e kryer jashtë kohës normale të bëhet kompensimi me pushim, brenda dy muajve nga kryerja e punës.

**Rekomandim nr.15:** Të plotësohet libri i pagave për vitet 2016-2017 -2018 nga nëpunësi zbatues.

**17. Gjetja** Në referencë të pikës 62, udhëzimi nr. 02, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte zbatimit Buxhetit”, të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi. Nga auditimi i dokumentacionit bankës për vitin 2016 rezultoi se është ekzekutuar vendimi përmbarimor me urdhër shpenzimit nr.120 datë 12.12.2016 për vlerë 1.130.052 lek për largim të padrejtë nga puna të një ish-punonjësi. Kryerja e ketij shpenzimi nuk ka qënë e parashikuar në buxhetin vjetor, nuk është bërë analizë e vendimit gjyqësor duke nxjerre dhe pergjegjësitë administrative.

**18. Gjetja** Në referencë të pikës 6 neni 40 i VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka një nevojë emergjente apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përlllogaritur e mallrave dhe shërbimeve nuk është më e madhe se 100.000 lekë.

Nga auditimi rezulton se janë kryer blerje emergjente nën 100.000 lek në 28 raste për vlerë 2.446.184 lek, ku veçojmë :

- 1. Mirmbajtjen e objekteve ndërtimore:** Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2017 janë planifikuar 120.000 lek për një rast, ndërsa janë kryer për 11 raste në vlerë 1.182.390 lek. Kryerja e këtyre shpenzimeve nuk ka patur emergjencë, hartimi i preventivave të mirëmbajtjes është kryer nga persona të jashtëm të cilët nuk kanë qënë të kontraktuar nga Qendra e Zhvillimit. Shpenzimet janë kryer pa bërë një vlersim paraprak nga specialistët e institucionit vartës. Preventivave të mirmbajtjes nuk u është bashkelidhur planimetria e nderhyrjes, ndërhyrjet janë kryer disa herë , duke bërë coptimin e fondeve dhe njëkohësishtë shmangien nga kryerja e procedurave të prokurimeve publike.
- 2. Riparime:** Në regjistrin e parashikimeve për vitin 2017, janë planifikuar 300.000 lek ndërsa janë kryer për 5 raste në vlerë 524.650 lek. Kryerja e këtyre shpenzimeve nuk ka patur emergjencë, hartimi i preventivave të riparimit është kryer nga persona të jashtëm të cilët nuk kanë qënë të kontraktuar nga Qendra e Zhvillimit. Shpenzimet janë kryer pa bërë një vlersim paraprak nga specialistet e fushës për të përcaktuar shkaqet e riparimit, si dhe nuk është bërë analize nëse vlera e riparimit është me e vogël se vlera e objektit të riparuar , është bërë coptimi i fondeve dhe njëkohësishtë shmangie nga kryerja e procedurave të prokurimeve publike. Si raste të veçanta mund të veçojmë riparimin e nje fotokopje me vlere 114.000 lek , ku nuk përcaktohen shkaqet e dëmtimit, lloji i fotokopjes që është riparuar. Riparimi i 3 kompjuterave me vlerë 118.200 lek, pa përcaktuar shkakun e dëmtimit, llojin e kompjuterit riparuar. Riparimi i automjetit për vlerë 97.440 lek i cili është nxjerrë nga bilanci ne vitin 2017 dhe në vitin 2018 është marrë makine me qera për kryerjen e shërbimit.

Marrja në dorëzim është kryer më pak se tre persona dhe në disa raste vetëm nga Nëpunësi zbatues duke vepruar në kundërshtim me pikat 42-43 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, ku marrja në dorëzim duhet të bëhet nga një komision i përbërë nga tre persona ku njëri duhet të jetë specialist i fushës.

**19 .Gjetja** Në referencë të nenit 7 të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, detyrimet ndaj kreditorëve duhet të shlyhen brenda 30 ditëve kalendarike. Nga auditimi ka rezultoi se faturat e energjise elektrike dhe te ujësjelles kanalizime jane kryer me vonesë për të gjithë periudhën e auditimit.

**Rekomandim nr.16:** Ky rekomandim do t’i propozohet titullarëve të Bashkisë Shkodër.



**20.Gjetja** Në referencë të neneve 5.6.7 të ligjit nr. 924 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, nëpunësi zbatues duhej të kishte mbajtur regjistrimet kontabile në ditare sipas llogarive planit kontabel të miratuar, evidencat financiare dhe librin e madh, nga auditimi i kryer rezultoj se nëpunësi zbatues me gjithë kerkesën disamujore për venien në dispozicion të regjistrimeve kontabile, evidencave librit madh, ky i fundit deklaroi se nuk ka kryer regjistrime kontabile nuk ka kryer rakordime cdo muaj me thesarin, gjithashtu dokumentet ligjore nuk janë mbajtur në dosje sipas muajve, nuk janë sistemuar sipas numrit progresiv të kryerjes veprimeve, këto veprime bien në kundërshtim me nenet 5.6.7 te ligjit nr. 924 date 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, pikën 117 udhëzimit nr. 02, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte zbatimit Buxhetit” Për këto veprime mban përgjegjësi nëpunësi zbatues, pikën 1.2 të udhëzimit nr.21 datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”.

**Rekomandim nr.17:** Të bëhet sistemimi i dokumentacionit sipas muajve si dhe regjistrimi sipas kërkesave të kontabilitetit.

**21.Gjetja** Në referencë të pikave 26, 27, 74, 81 të udhëzimit Ministrisë Financave nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njesite e sektorit publik”, kapitullit VI rregullores asetëve të Bashkisë Shkodër, miratuar me Vendimin e Kryetares Bashkisë nr. 449 datë 15.07.2016 “Për miratimin e rregullores menaxhimit aktiveve të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve vartësisë saj”, titullari i njësive ngarkon nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit kontabël të aktiveve, aktivet kontrollohen të pakten një herë në vit, Inventarizimi kryhet nga një komision i posaçëm që krijojet me urdhër të Titullarit te njesise publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga Nëpunësi Zbatues në bazë të të dhënave të rregjistrave kontabël të aktiveve të njësive. Komisioni i vlerësimit të aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale kontrollon dhe vlerëson një për një çdo aktiv dhe përcakton drejt shkallën e amortizimit dhe destinacionin e përdorimit për ripërtëritje të aktiveve : **a.** Nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësive; **b.** Nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të metejshëm në njësi të tjera; **c.** Nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar. Nga auditimi i kryer ka rezultuar se është ngritur komisioni i vlersimit te aktiveve, por ky i fundit nuk ka kryer detyrat e ngarkuara sipas udhëzimit të mësipërm dhe rregullores së asetëve, janë mjaftuar me nje regjister i cili përmban të dhënat e gjendjes kontabile, ndërsa mungojnë të dhenat e gjendjes fizike, shtesat dhe pakësimet. Këto veprime bien në kundërshti me udhëzimin e mësipërm dhe rregulloren e menaxhimit asetëve.

**Rekomandim nr.18:**Të ngrihet komisioni i vlersimit të aktiveve , nëpunësi zbatues të hartojë regjistrin kontabel të aktiveve, ndërsa komisioni të bëjë vlersimin sipas kërkesave të rregullores menaxhimit asetëve të Bashkisë Shkodër.

**22.Gjetja** .Në referenë të pikave 103-106 të udhëzimit Ministrise Financave nr. 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njesitë e sektorit publik” i ndryshuar, vendimit nr.449 datë 07.12.2016 “Për miratimin e rregullores për menaxhimin e asetëve” kapitulli VI.3, komisioni i vlersimit të aktiveve duhej të kishte bërë vlersimin e aktiveve për dalje jashte përdorimi, duhej të kishte hartuar procesverbalin e nxjerrjes jashte përdorimi , si dhe të shoqerohej me relacion sqarues për Drejtorinë e Qendrës Zhvillimit. Nga auditimi i kryer bazuar në pasqyrat financiare rezultoi se është pakësimi për dy mjete transporti me vlerë 1.150.000 lek dhe inventar ekonomik me vlere245.248 lek. Pa ndjekur procedurën që cituam më lart.

**Rekomandim nr.19:** Të bëhet kërkesë pranë Bashkisë Shkodër , për të vënë në dispozicion specialistë të mjeteve të transportit për të bërë vlersimin e mjeteve. Komisioni i vlersimit asetëve të mbaj proces – verbal për dalje jashtë përdorimi, si dhe relacion sqarues për dalje nga përdorimi. Më pas të bëhet kërkesë pranë bashkisë Shkodër për miratim të daljes jashtë përdorimi, dhe nëse miratohet të ngrihet komisioni i i nxjerrjes jashtë përdorimi sipas kërkesave të udhëzimit të mësipërm.

**Rekomandim nr.20:** Deri në përfundim të procesit të daljes jashtë përdorimi, aktivet e pakësuara në vitin 2017 të rikthehen në kontabilitet.

**Administrimi i karburantit:** Qendra e Zhvillimit konsumon lëndë djegëse për mjetin e transportit dhe për kaldajën. Nga auditimi i kryer rezultoi se nuk është ngritur komision me specialistë të fushës për vlersimin e lëndës djegëse të konsumuar për km ose orë. Nuk janë ndjekur procedurat e kërkuara nga rregullorja e asetëve të bashkisë Shkodër për administrimin e lëndës djegëse, nuk është bërë vlersimi dhe dokumentimi i rrugës që përshkon mjete në ditë.

**Rekomandim nr.21:** Të kërkohet me shkrim pranë Bashkisë Shkodër për vënie në dispozicion specialistë për vlersimin e intinerarit të lëvizjes mjeteve transportit dhe konsumin e karburantit për “km ose orë” .

**Rekomandim nr.22:** Për administrimin e lëndës djegëse të kërkohet asistencë pranë bashkisë Shkodër për të bërë administrimin sipas kërkesave të rregullores .

**Njësia Auditimit Brendshëm**

**Bashkia SHKODER**

